URDHËR
Nr. 58, datë 22.6.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kreut II, "Organizimi dhe funksionimi i agjencisë", të VKM-së nr. 725, datë 2.9.2015, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit" dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 91, datë 24.5.2016, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Drejtorit të Drejtorisë Juridike znj. Alisa Ramollari.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën 10.7.2016 deri më 17.7.2016.
3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet znj. Alisa Ramollari.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT
TË TERRITORIT
Ledia Tota